




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Kalendari i dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për KAB 2026-2028

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL-së për Administratë të Hapur në Komuna, kryetari i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve publike me qytetarë për përgatitjen e KAB (Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028).

KAB-i është dokument i rëndësishëm për planifikimin e buxhetit dhe hartimin e listës së investimeve kapitale kurse përmes dëgjimeve buxhetore qytetarët bëhen pjesë e vendimmarrjes. Këto dëgjime do të mbahen me datat 3 dhe 4 Qershor 2025 sipas kalendarit të mëposhtëm. Në këto dëgjime buxhetore mund të marrin pjesë: qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-të, komunitetet e ndryshme, gratë, pensionistët, të rinjtë dhe studentët, bizneset, përfaqësues nga institucione të ndryshme dhe qytetarë të tjerë pa dallim.

Dëgjimi buxhetor	Dita/data e mbajtjes	Vendi	Ora
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Likofcit	E martë, 03 Qershor 2025	SHFMU "Fehmi Rama", Likofc	13:30
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Qirezit	E martë, 03 Qershor 2025	SHFMU "Dëshmorët e Qyqavicës", Qirez	15:00
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Turiqefcit	E mërkurë, 04 Qershor 2025	SHFMU "Abedin Rexha" Turiqefc	13:30
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Runikut	E mërkurë, 04 Qershor 2025	SHFMU "Shotë Galica", Runik	15:00
Dëgjimi buxhetor në Bashkësinë Lokale të Klinës së Epërme	E mërkurë, 04 Qershor 2025	SHFMU "Idriz Barani"	16:00

Për më shumë detaje, për Qarkoren buxhetore përmes të cilës hartohet Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Skenderajt mund të vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Qarkorja-Buxhetore-2026-01_SE-komente_07052025.-shqip.pdf

Platforma qendrore e konsultimeve publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42825>

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni në emailat: ismet.aliu@rks-gov.net dhe jeton.rushiti@rks-gov.net.

Amir Lushtaku

Udhëheqës i Zyrës për Informim